Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0977

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani si paneliste individualiste duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " NMA " SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të N.P.K." TRAFIKU URBAN " SH.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i rrezikut në punë dhe mjedisit të punës" me numër të prokurimit TU-23-10363-2-2-1, me 02/02/2024, mori:

Vendim

I. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "NMA" SH.P.K. me nr. 2023/0977, e datës 04/12/2023 ndaj vendimi i AK N.P.K. "TRAFIKU URBAN " SH.A. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i rrezikut në punë dhe mjedisit të punës" me numër të prokurimit TU-23-10363-2-2-1, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

III. Lejohet kthimi i tarifave të ankesave në shumën e deponuar ashtu që obligohen operatorët ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrojnë kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 27.09.2023, Ndërmarrja Publike N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i rrezikut në punë dhe mjedisit të punës" me numër të prokurimit TU-23-10363-2-2-1. Ndërsa me njoftimin e datës 16.11.2023 ka publikuar vendimin sipas të cili është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik N.N. Bli TERM.

Me 21.11.2023, operatori ekonomik "NMA "SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim e vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e autoritetit kontraktues të datës 24.11.2023.

Me 04.12.2023, operatori ekonomik me të dhëna si më sipër, ka ushtruar ankesë [evidentuar me numër protokolli Nr. 977/23] kundër vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues.

Në fazën e shqyrtimit paraprak, OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake, sikurse kërkohet në kuptim të nenit 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet nenin 4, paragrafi 1.26, lidhur me nenin 105, paragrafi 1 të LPP, kurse ankesa i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet në kuptim të nenin 111, të Ligjit të cituar, d.t.th. se e njëjta bije nën kompetencat e këtij Organi në kuptim të nenit 98 dhe 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Bazuar në veprimet si më sipër, OSHP ka emëruar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që të bëhet shqyrtimi fillestar i dosjes dhe pretendimeve ankimore, sikurse kërkohet kjo sipas nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar.

Lidhur me ketë, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me 12.12.2023, i cili përmban dhe rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet Vendimi për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne rivlerësim;

Paneli konstatoi paraprakisht se Raporti i ekspertit shqyrtues i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga palët, sikurse kërkohet me nenin 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në ketë evidentohet se është pajtuar me raportin e cituar, ndërsa AK nuk është pajtuar. Po ashtu konstatohet se palët janë të informuara [nga platforma e prokurimit elektronik] lidhur me shkresat e lëndës në përbërje komplete, sikurse kërkohet me paragrafin 2 të nenit 20 të kësaj Rregulloreje, andaj janë krijuar kushtet [prezumimet] procedurale që përkitazi me ankesën të vendoset meritorisht.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli konstatoi paraprakisht se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.75, lidhur me nenin 11 të Rregullores për Punën e OSHP, andaj analizoi në vijim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të caktohet seanca publike me palë, meqë shkresat e kësaj lënde përmbajnë prova të mjaftueshme lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen meritore sipas nenit 24.1, të Rregullores së cituar, kurse ky aktivitet i prokurimit tani më është i njohur për OSHP. Në ketë rast pretendimet ankimore, parashtresat, aktet dhe veprimet e palëve, të ankuesit dhe AK dhe raporti i ekspertit, gjatë administrimit të gjithmbarshëm të provave, janë analizuar dhe prezantuar në kontekstin e çështjeve relevante, sikurse në vijim të këtij arsyetimi.

Ankuesi ka pohuar se Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të ofertave në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP, duke i shpjeguar faktet dhe rrethanat në raport me secilën nga dispozitat e cituara, mirëpo pa nevojë që tani ato të përshkruhen sërish në ketë rast. Në fakt, duke i analizuar të gjitha shkresat e kësaj lënde, krahas pohimeve ankimore Paneli i analizoi me kujdes po ashtu aktet dhe veprimet e autoritetit kontraktues dhe shpjegimet të cilat raporti i ekspertit shqyrtues i përmban dhe vëren, natyrisht nga pikëpamja e tij/saj, se çështjet kontestuese në esencë përbëhen nga dy faktet e veçuara në ketë rast dhe atë:

- Lidhur me faktin e noterizimit të dokumenteve të kërkuara;
- Lidhur me vlerat krahasuese të ofertës së ankuesit dhe asaj të rekomanduar për kontratë;

Në ketë rast, duke i analizuar paraprakisht por pa nevojë për ti prezantuar dhe/ose përshkruar në detaje të gjitha ato, Paneli vëren se në raportin e ekspertit shqyrtues janë analizuar me kujdes të gjitha faktet të cilat me të drejtë janë konsideruar nga ana e tij/saj si relevante dhe po ashtu janë shpjeguar në mënyrën e duhur në raport me kuptimin e dispozitave përkatëse të LPP. Kështu eksperti, në mënyrën e duhur e ka shpjeguar kuptimin e nenit 1 të LPP, i cili vërtetë ju referohet apriori nëpunësve të administratës publike dhe detyrimit që kanë për të manifestuar integritet, përgjegjësi dhe kulture institucionale në procesin e prokurimit me fonde publike dhe se e njëjta nuk e rregullon procesin ankimor. Po ashtu dhe mënyra se si është komentuar dispozita e nenit 6 e LPP nga ana e ekspertit shqyrtues është pranuar edhe nga ana e këtij Paneli, sepse në kuptimin përmbajtjesor vërtetë siç është thënë nga ana e ekspertit, neni 6 nuk ka te beje vetëm me çminimi por edhe kushtet tjera dhe se zbatimi i të gjithave së bashku garanton barazinë e palëve para ligjit, nga aspekti se si kërkohet kjo me LPP. Dhe lidhur me ketë eksperti ka konstatuar se, AK nuk ka respektuar nenin 6, përderisa janë kërkuar dhe kushtet tjera kurse diploma e... [emri në shkresa] si njëra nga ato është kopje, por nuk është e notorizuar. Nisur nga ky aspekt eksperti ka dhënë mendimin se "është vlerësuar oferta e ankuesit, por jo ne përputhje me nenin 72 te LPP, qe mundet te cilësohet se është bere një diskriminim nga AK-ja këtij OE ankues". Mirëpo, meqë sipas tij/sajë, diploma dhe licenca nuk janë te noterizuar siç është kërkuar ne dosjen e tenderit, pretendimi ankimore është pjesërisht i bazuar.

Më tej, në raportin e ekspertit shqyrtues thuhet se është bere shkelje e nenit 59 [Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve] pasi nuk është bere vlerësim profesional i ofertave, sepse ne baze te nenit 72 lidhur me nenin 69 [Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale] te LPP, është dashur të kërkohet nga ankuesi që Licencën dhe Diplomën ti sjell te noterizuara pasi janë dokumente qe kane te bëjnë para publikimit të njoftimit për kontrate, me synimin që vlerësimi i të gjitha kushteve të realizohet ashtu sikurse kërkohet në kuptim të nenit 59. Paneli konsideron se eksperti ka të drejtë meqë kërkimi i sqarimeve për dokumente paraprakisht të dorëzuara dhe/ose të njohura për AK, nuk përbejnë ndryshim material të dosje së tenderit, sikurse shpjegohet

shprehimisht me paragrafin 2, të nenit 59. Sipas ekspertit, ankuesi ka theksuar ne kërkesën për rishqyrtim se i posedon te noterizuar licencën dhe diplomën por... "nuk është ngarkuar failli i noterizimeve" dhe meqë AK ka abstenuar nga ndërmarrja e veprimeve siç e kërkojnë dispozitat si më sipër, eksperti ka konstatuar se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se eliminimi i ankuesit nga ky aspekt në kundërshtim me kërkesat e ligjit te prokurimit, duke ju referuar në ketë rast nenit 64 [Dëshmitë e kërkesave] te LPP por duke ju referuar njëherësh dhe Vendimit te OSHP PSH Nr. 0467/2023, sipas pohimit të ankuesit. Në raportin e ekspertit shqyrtues po ashtu është analizuar dhe pretendimi i ankues në raport me nenin 60 i LPP, për çfarë sipas ekspertit ky pretendim qëndron pasi kompania ankuese është me çmim me te ulet 12,495.00 € ndërsa kompania e rekomanduar për kontrate ka çmim 18,130.00 €.

- *Konstatimet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli konsideron se faktet e analizuara, të shpjeguara dhe konstatimet e dhëna në raportin e ekspertit shqyrtues janë të bazuara dhe konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe krijoj bindjen se pohimet ankimore duhen konsideruar të bazuara. Paneli konsideron se në dosjen e tenderit, pika 4, vërtetë është kërkuar, cituar "Diplomat dhe Certifikatat apo autorizimet e gjithë stafit duhet të jenë të noterizuara nga vet personi përkatësisht bartësi i dokumentit". Dhe është vërtetë "Nuk është nen përgjegjësinë e AK a dorëzohen fajllet origjinal apo fajllet e noterizuar kjo është nen autoritetin e Operatoreve Ekonomik kur i dorëzojnë ofertat përmes platformës se e-prokurimit". Mirëpo, mungesa e veprimeve të ndërmarra në kuptim të Kreut V, të LPP lidhur me Kërkesat e përshtatshmërisë dhe të kualifikimit, i ka dhënë të drejtë ankuesit për ta atakuar Vendimin e AK, tani në ketë rast edhe lidhur me vlerën e ofertës së tij.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si me sipër.

- *Përfundim* -

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi, gjithashtu me anë të këtij vendimi i informon të gjith OE ofertues në këtë aktivitet, meqenëse kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit nga AK nuk janë atakuar me kohe në fazën fillestare kundër kritereve pranë OSHP-së, atëherë objektivisht lind obligimi për secilin OE ofertues në këtë aktivitet se të njejtat duhet të plotësohen si të tilla pa prejashtim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.**
- OE - **" NMA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: